

Menirele t'ia

Pet enkim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Nr. 4095 Prot. (B.H)

Kopje Nr. \_\_\_\_\_  
Shkodër, më 25/05/2021.

**Lënda :** Dërgohet Vendimi i Prokurorit "*Për mosfillimin e procedimit penal*".

**Drejtuar :** Partia Demokratike E Shqipërisë

TIRANË

Bashkëlidhur kësaj shkrese, po ju dërgojmë Vendimin e Prokurorit "*Për mosfillimin e procedimit penal*" në lidhje me kallëzimin penal nr.540 datë 12 Maj 2021.

DREJTUES I PROKURORISË

ALBERT MURÇAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Adresa : Rruga "Et'hem Osmani,"

V E N D I M

**PËR MOSFILLIMIN E PROCEDIMIT PENAL**

Në Shkodër, më datë 24 Maj 2021.

Unë **Blerta HAMZA**, Prokurore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, pasi studiova aktet e kallëzimit penal **nr.540 datë 12 Maj 2021;**

K O N S T A T O V A :

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër mbi bazën e materialit kallëzues të përcjellë nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka regjistruar kallëzimin penal **nr.540 datë 12 Maj 2021** për kryerjen e veprave penale "*Shpërdorim i detyrës*" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe "*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*" parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal.

***I. Rrethanat e faktit.***

Nga shqyrtimi i materialit kallëzues rezulton se Partia Demokratike e Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga shtetasi Gazment Bardhi, pretendon ndër të tjera se në datën 25 Prill 2021 u zhvilluan zgjedhjet parlamentare të cilat u shoqëruan me shkelje të rënda ligjore dhe përfshirje në masë të personave me rekorde të rënda kriminale në funksion të maksimizimit të votave për Partinë Socialiste.

\_\_\_\_\_ është person me rekorde të rënda kriminale dhe së bashku me vëllain e tij \_\_\_\_\_ jtor i ndërmarrjes "Ujësjetllës-Kanalizime" sh.a në Vaun e Dejës, njihen si mbështetësit kryesorë të Partisë Socialiste në zonë. Në datën 21 Prill 2021, pra, 4 ditë përpara zgjedhjeve, ky shtetas është arrestuar në flagrancë nga Drejtori i Policisë, \_\_\_\_\_ pasi ka

qënë duke qarkulluar me një automjet të blinduar brënda të cilës janë gjetur një pistoletë “Glock”, një kallashnikov me 1 krëhër, shuma të mëdha parash për blerje vote si dhe material zgjedhore dhe lista të banorëve të zonës.

Pas arrestimit ky shtetas është lënë i lirë me urdhër të [REDAKTUAR] njohja e të cilëve është e faktuar edhe nga një video e datës 31 Mars 2021. Kanë qënë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kandidat për deputet i Partisë Socialiste në zonën e Shkodrës të cilët kanë telefonuar fillimisht [REDAKTUAR] dhe më pas [REDAKTUAR] kanë kërkuar lirimin e shtetasit [REDAKTUAR] lirim të të vëllait ky i fundit iu ka kërkuar të punojnë sa më fort për Partinë Socialiste.

Partia Demokratike e Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga shtetasi Gazment Bardhi, pretendon gjithashtu se [REDAKTUAR] kanë punuar me çdo mjet dhe mënyrë të kundraligjshme për blerje vote dhe ndryshim të rezultatit të zgjedhjeve në Vaun e Dejës ndërsa djemtë e xhaxhati të tyre me të njëjtën mënyrë kaën punuar për blerje vote në favor të kandidatit [REDAKTUAR].

## *II. Analiza e çështjes.*

Për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve të saj të marra së bashku, të cilët janë: **a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive.** Provuashmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Për rrjedhojë, në çdo rast konkret duhet verifikuar ekzistenca e të gjithë elementëve të veprës penale dhe të figurës së saj në veçanti.

Organi i akuzës çmon se në rastin konkret nuk janë konsumuar elementët e asnjë prej veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Konkretisht, Partia Demokratike e Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga shtetasi Gazment Bardhi pretendon se 4 (katër) ditë përpara zgjedhjeve elektorale të datës 25 Prill 2021 nga Drejtori i Policisë Vendore, Shkodër [REDAKTUAR] është arrestuar në flagrancë shtetasi [REDAKTUAR] pasi ka qënë duke qarkulluar me një automjet të blinduar brënda të cilës janë gjetur një pistoletë “Glock”, një

kallashnikov me 1 krëhër, shuma të mëdha parash për blerje vote si dhe material zgjedhore dhe lista të banorëve të zonës. Pas arrestimit ky shtetas është lënë i lirë me urdhër të Kryeministrit Edi Rama, njohja e të cilëve është e faktuar edhe nga një video e datës 31 Mars 2021. Kanë qënë shtetasit Ilir Babaj/Baba (vëllai i shtetasit Basri Babaj/Baba dhe drejtor i ndërmarrjes "Ujësjiellës-Kanalizime" sh.a në Vaun e Dejës) dhe Frrok Gjini, kandidat për deputet i Partisë Socialiste në zonën e Shkodrës të cilët kanë telefonuar fillimisht Ministrin e Brëndshëm Blendi Çuçi dhe më pas Kryeministrin Edi Rama dhe kanë kërkuar lirim të shtetasit Basri Babaj/Baba.

Sipas Kodit të Procedurës Penale<sup>1</sup> kallëzimi përmban elementet thelbësore të faktit, burimet e provës, gjeneralitetet, banimin dhe çdo gjë tjetër që vlen për identifikimin e personit të cilit i atribuohet fakti, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të sqarojnë rrethanat e faktit. Bashkëlidhur kallëzimi penal të Partisë Demokratike ndodhet vetëm një foto në të cilën duken Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama dhe shtetasit Frrok Gjini dhe Ilir Babaj/Baba. Pretendimet e këtij subjekti janë "hamendësime" të përgjithshme për biseda telefonike të zhvilluar midis shtetasve Ilir Babaj/Baba dhe Frrok Gjini me Ministrin e Brëndshëm Blendi Çuçi dhe më pas Kryeministrin Edi Rama me qëllim lirim të shtetasit të arrestuar Basri Babaj/Baba. Por bashkëlidhur kallëzimit penal nuk ndodhet asnjë provë apo qoftë edhe indicje me anë të të cilave të krijohen dyshime të arsyeshme për konsumimin e elementëve të veprave penale "*Shpërdorim i detyrës*" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe "*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit*" parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal nga shtetasit Niko Brahimaj, Ilir Babaj/Baba dhe Basri Babaj/Baba në mënyrë që të lindë nevoja për kryerjen e hetimeve të mëtejshme për zbulimin e tyre dhe të autorëve përkatës. Në lidhje me arrestimin e shtetasit Basri Babaj/Baba, i cili ka qënë duke qarkulluar me një automjet të blinduar brënda të cilës janë gjetur një pistoletë "Glock", një kallashnikov me 1 krëhër, shuma të mëdha parash për blerje vote, material zgjedhore dhe lista të banorëve të zones, kallëzuesi nuk ka bashkëlidhur asnjë provë apo indicje që të provojë ose të paktën të krijojë dyshimin se ekziston një fakt i tillë, përfshi këtu ndonjë dokument apo gjeneralitet të personave të pranishëm në arrestimin e këtij shtetasi.

---

<sup>1</sup> Shiko nenin 281/4 të saj.

Ndërsa, për sa i përket personave të tjerë të përmendur në kallëzimin penal theksojme se bazuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 3 të ligjit nr.96/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” hetimi i tyre nuk është në kompetencën e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër por të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për shkak të cilësive të veçanta që ata kanë.

Organi i akuzës çmon të theksojë se në bazë të kallëzimeve penale të bëra nga ky subjekt nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër janë regjistruar disa procedime penale dhe kanë filluar hetimet për sqarimin e çështjeve por në rastin konkret nuk ekziston asnjë prej elementëve të parashikuar nga ligji me qëllim regjistrimin e një procedimi penal.

### **III. Konkluzioni.**

Vepra penale konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë atëherë kur ekzistojnë të katër elementët e saj: *objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive*. Nëse mungon apo nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë vepra penale nuk ekziston.

Për rrjedhojë, bazuar në materialet dhe provat e administruara në kuadër të këtij kallëzimi penal vlerësohet se në rastin konkret nuk mund të procedohet me regjistrim të procedimit penal përse kohë që fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Në këto kushte, bazuar në nenin 290/ç të Kodit të Procedurës Penale në të cilin parashikohet se: “Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje dhe fazë të procedimit kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë se fakti nuk ekziston” dhe në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale në të cilin parashikohet se: “Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e tij”,

## **V E N D O S A :**

**I. Mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr.540 datë 12 Maj 2021.**

2. Ky vendim ti njoftohet personave të interesuar nga sekretaria e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër.
3. Kundër ketij vendimi, mund te bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i vendimit.

**PROKURORE E ÇËSHTJES**

**BLERTA HAMZA**

